

VENDIM
Nr.807, datë 6.12.2006

PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTIT TË STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË
INDUSTRISE SË LEHTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ristrukturimin e Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Industrisë së Lehtë dhe përfshirjen e tij në Inspektoratin Qendror Teknik (IQT).
2. Buxheti i miratuar për vitin 2006, për Institutin e Studimeve dhe Projektmeve të Industrisë së Lehtë, i kalon IQT-së.
3. Punonjësit, që do të dalin të papunë nga ky ristrukturim, të trajtohen nga buxheti i IQT-së, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Vendimi nr.348, datë 29.9.1990 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Industrisë së Lehtë”, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha